

# Informacione për detyrimin e mbrojtjes nga virusi Covid-19

Që nga dt. 27 prill 2020 të gjithë personat duke filluar nga mosha 6 vjeç duhet të mbajnë një maskë mbrojtëse për gojën dhe hundën (maskë ndihmëse)

- gjatë bërjes së pazarit
- në autobusët, tramvajet ose në tren

ASNJË detyrim për mbajtjen e maskës mbrojtës kanë persona, të cilët për arsye mjekësore nuk mund të mbajnë një maskë (Pyesni mjekun tuaj për një vërtetim!). Persona, të cilët për shkak të aftësive të tyre të kufizuara nuk mund të vendosin ose heqin një maskë dhe njerëz të shurdhër nuk duhet të mbajnë ASNJË maskë.

## Udhëzime dhe sugjerime për mbajtjen e një maske në kohën e koronavirusit

### **Cilën maskë duhet të përdor unë?**

Një mbulesë e thjeshtë për gojën dhe hundën mjafton.

Ju mund të vendosni edhe një shall ose një leckë para hundës dhe gojës.

### **Pse duhet të përdor unë një maskë?**

Maska mund të ndihmojë për të mos infektuar njerëz të tjerë.

Maska mund të jetë si një barrierë: Ajo ndihmon që pikat e veta, për shembull gjatë të folurit, kollitjes ose teshtitjes nuk arrijnë tek të tjerët.

Maskat prej stofi nga prodhimi vetjak, maskat për operacione (maska për një përdorim), gjysmëmaska (FFP2 dhe FFP3) janë të përshtatshme.

Është e arsyeshme që të mbahet një maskë, edhe kur nuk ke asnjë simptomë të sëmundjes.

### **E RËNDËSISHME!**

**Regullat e deritanishme për higjienën dhe mbrojtjen vazhdojnë të vlejnjë dhe duhet të merren parasysh patjetër. Mbrojtja e gojës është një PLOTËSIM për këto masa të mbrojtjes!**

**Maska NUK është një mbrojtje absolute nga infektimi!**

### **Çfarë duhet të marrë unë parasys, nëse unë përdor një maskë?**

- Para vendosjes, ju lutemi, lani gjithmonë duart.
- Gjatë vendosjes **mos** e prekni anën e brendshme të maskës.
- Kapeni maskën gjithmonë **në llastiqet**.
- Maska duhet të mbulojë **hundën, gojën dhe pjesë të mollëzave**.
- Maska duhet të jetë **e ngjitur me fytyrën**.
- Maska duhet të lërë **ajër të mjaftueshëm** për të marrë frymë.
- Mos e prekni fytyrën ose maskën gjatë mbajtjes.
- Ndërroni një maskë të lagur kundrejt një maske të thatë.
- 

#### **Pas përdorimit**

- **Hiqeni** maskën **vetëm me anë të llastiqeve**. **Mos e kapni maskën në stof**.
- Maskat e përdoruar vendosini deri në larjen në një qese plastike që mund të mbyllet.
- Maska **duhet të lahet me të paktën 60 ° gradë deri 95 ° gradë në tenxhere ose në makinën larëse**.
- Përdorni vetëm maska të lara dhe të thara plotësisht.

### **A duhet të paguaj unë një gjobë, nëse unë nuk mbajë një maskë?**

Detyrimi për mbajtjen vlen që nga dt. 27 prill 2020. Që nga dt. 4 maj 2020 në landin Baden-Württemberg mund të kërkohet një gjobë, nëse konstatohet një kundërvajtje kundër detyrimit për të mbajtur një maskë.

### **Informacione për rregullat e higjienës dhe mbrojtjes nga infeksione ju gjeni nën**

<https://www.mannheim.de/de/informationen-zu-corona/allgemeine-hygienemassnahmen-infektionsschutz>